



Bazuar në dispozitat e nenit 16 të Ligjit për ndërmarrjet publike 03/L-087 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.31 dhe në Marrëveshjen për Partneritet Publik-Privat 02 nr. 348 dt. 28.05.2012, Komuna e Gjiçanit shpall :

## K O N K U R S

Për zgjedhjen e 1 (një) anëtarit të Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes "Eco - Higjiëna " Gjiçan.

Pozita sipas marrëveshjes është e përcaktuar ti takojë Komunës së Vitisë dhe Komunës së Kamenicës me rotacion, duke i ndarë nga 1.5 vite për secilën nga këto komuna, në rast të mosplotësimit të kushteve dhe kriterëve të kandidatëve nga këto dy komuna, atëherë merren në konsideratë edhe kandidatët tjerë të cilët kanë aplikuar.

Mandati i drejtorit të zgjedhur është tre (1.5) vjet.

### KOMPENSIMI I DREJTORËVE TË NDËRMARRJES "ECO-HIGJIENA" Gjiçan

Kompensimi i Drejtorëve të Bordit "Eco- Higjiëna " do të bëhet në pajtim me dispozitat e nenit 20, pika 20.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

### KUALIFIKIMET DHE PËRGADITJA PROFESIONALE

Sipas nenit 17, pika 17.3 të Ligjit mbi ndërmarrjet publike, një kandidat për t'u zgjedhur drejtor në Bordin e Drejtorëve duhet ti plotësojë këto kushte :

- të jetë person që ka integritet të njohur, duke marrë parasysh ndër të tjera çfarëdo shkelje të detyrave financiare që mund të ketë bërë ky person ndaj cilit do person tjetër;
- të ketë përgatitje superiore;
- të ketë së paku 5 vite përvojë pune në nivel të lartë të menaxhmentit – në fushën e administrimit të biznesit, të financave të korporatave, të financave, të menaxhimit të thesarit, të bankave, konsulentë në biznes ose industri ose nga një fushë tjetër e shkencave - të ketë qenë kontabilist publik, jurist i kualifikuar, ose anëtar i kualifikuar i një profesioni tjetër i cili ndërlidhet ngushtë me veprimtarinë afariste të NP –së

### KUSHTET

**Kandidati ka të drejtë të zgjidhet në Bordin e NPL–së, nëse :**

- nuk ka qenë i dënuar dhe nuk është nën hetime nga një Gjykatë kompetente ;
- nuk ka shkelur kodin etik apo standardet e sjelljes profesionale, përveç nëse një dënim i tillë është ndryshuar nga një Gjykatë ose organ tjetër i ankesave
- nuk ka bërë përgënjeshtime materiale nën çfarëdo dëshmie nën betim nuk ka qenë në post menaxhues të ndonjë kompanie që ka falimentuar gjatë dhjetë (10) viteve të fundit

**Kandidati nuk mund të zgjidhet drejtor në Bordin e NPL–së nëse :**

- aktualisht është zyrtar (në kuptim të nenit 21 të Ligjit mbi ndërmarrjet publike) menaxher i ndërmarrjes përkatëse, ose cilëndo nga filialet e saja ;
- ka shërbyer si menaxher i ndërmarrjes publike përkatëse, ose cilëndo nga filialet e saja brenda pesë (5) viteve të kaluara ;
- aktualisht ka ose gjatë tri (3) viteve të kaluara ka pasur çfarëdo marrëdhënie materiale afariste (përveç si konsumator individual i shërbimit të ndërmarrjes publike) me ndërmarrjen publike përkatëse, ose cilëndo nga filialet, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ;

- është aksionar, drejtor ose zyrtar në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik i cili ka marrëdhënie materiale afariste me ndërmarrjen publike përkatëse ;
- pranon ose ka pranuar brenda tri (3) viteve të kaluara kompensimin shtesë nga ndërmarrja publike përkatëse, ose nga cilado filiale e saj (përveç honorarit të drejtorit ose kompensimin stimulues të përcaktuar me nenin 20.1 të Ligjit mbi ndërmarrjet publike, ose është anëtar në skemën pensionale të ndërmarrjes publike përkatëse ose të cilësdo nga filialet e saja ;
- përfaqëson një aksionar i cili posedon mbi dhjetë përqind (10%) të aksioneve votuese në ndërmarrjen publike përkatëse;
- ka shërbyer në Bordin e drejtorëve të ndërmarrjes publike përkatëse më shumë se nëntë (9) vite nga dita e parë e zgjidhjes së tij ;
- është i afërm i shkallës së tretë (siç është konstatuar në përputhje me përkufizimin e interesit financiar në nenin 2 të Ligjit mbi ndërmarrjet publike ), i cilitdo person që i takon cilësdo nga kategoritë e sipërpërmendura ;
- është zyrtar drejtor ose aksionar, ose ka një interes financiar në një shoqëri tregtare që konkurron me ndërmarrjen, ose është menaxher i lartë zyrtar, drejtor ose aksionar (i cili posedon me shumë se dy përqind (2%) të drejtave të votimit), ose ka një interes të konsiderueshëm financiar në cilëndo nga shoqëritë tregtare që konkurrojnë në ndërmarrjen;
- është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 mujore para datës së aplikimit, ka qenë zyrtar i zgjedhur, i emëruar politik ose bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;
- ka çfarëdo konflikti të interesave që, për nga natyra, do të shkaktojnë që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë efektive, me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përmbushë detyrat e tij përgjegjëse ndaj aksionarëve dhe ndërmarrjes publike.

## INFORMATË PËR PROCEDURËN E KONKURIMIT

Kandidatët për drejtor në bordin e Bordin e Ndërmarrjes “Eco-Higjiena” Gjilan duhet t'i dorëzojnë provat e mëposhtme :

- CV- në,
- Letër motivimin ;
- Deklaratën nën betim (formular i cili plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit);
- Dëshminë e kualifikimit profesional ;
- Dëshminë mbi përvojën e punës ;
- Certifikatën që s'është nën hetime dhe
- Certifikatën e lindjes.

Aplikuesit duhet të përgatisë deklaratën nën betim, në të cilin deklaron se ai/ajo i përmbushë kushtet e kualifikimit, pavarësinë dhe përgatitjen profesionale çdo përgënjeshtër material, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipërpërmendur do të rezultojë me diskualifikimin e menjëhershëm .

Dokumentacioni duhet të jetë në zarf të mbyllur dhe dorëzohet në Qendrën për Shërbime të Qytetarëve ,rr. Skënderbeu, p.n. Gjilan në adresë: Komuna e Gjilanit për konkursin Bordin e Ndërmarrjes “Eco-Higjiena”.

Informatat shtesë mund të sigurohen përmes numrit të telefonit: 0280 320 781

Afati i konkursit është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Gjilan, me 17 Janar 2013